



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - UredPremijera - Office of the Prime Minister


Nr. 129/ 2026
Datë: 31.07.2026

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 9 (3) të Ligjit Nr. 04/L-023 për Personat të Zhdukur (G.Z. e Republikës së Kosovës /Nr. 16/14 shtator 2011), nenin 9 (1.3, 1.4) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerr:

V E N D I M

1. Z. Agron Limani emërohet Kryesues i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur, me Rregulloren Nr. 15/2012 për Punën e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur (10.07.2012) dhe legjislacionin në fuqi.
3. Z. Agron Limani, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është i obliguar të bëjë deklarinë e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. I emëruari e fillon mandatin në pozitën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi më 01.08.2026.
5. Mandati i të emëruarit përfundon me përfundimin e mandatit të autoritetit emërues, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- *Z. Agron Limani, Kryesues i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur;*
- *Shefes së stafit të Kryeministrit;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Zyrës për Buxhet dhe Financa në ZKM*
- *Arkivit të Qeverisë.*